

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"A2Farma"

Sot, më datë 14/01/2025,

Arlind Spahija shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 14/04/1989, lindur në Shkodër me nr. ID 190414117H, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034796378 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit,

Arsit Hoxha shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 06/05/1995, lindur në Shkodër me nr. ID: J50506095B, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 036583816 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit;

vendosen të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është "**A2Farma**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**A2Farma**" Sh.P.K.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objekti i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Import-eksport, ruajtje, shperndarje, shitje me shumice e pakice te artikujve farmaceutik dhe parafarmaceutik, shtesave ushqimore dhe produkteve bimore, produkteve kozmetike, bimeve medicinale .Çdo aktivitet ndihmes ne perputhje me legjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj kryesor.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**A2Farma**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Import-eksport, ruajtje, shperndarje, shitje me shumice e pakice te artikujve farmaceutik dhe parafarmaceutik, shtesave ushqimore dhe produkteve bimore, produkteve kozmetike, bimeve medicinale .Çdo aktivitet ndihmes ne perputhje me legjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj kryesor.



NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodrës me adresë: Shkodër, Lagjja Qemal Stafa, Rruga Studenti, Nr. pasurie 2/1214, Zona kadastrale Nr. 8591.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **2,000,000** (2 Milion) lekë, i ndarë në 2 kuota ku një kuotë ka vlerën **1,000,000** lekë.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare me emrin "**A2Farma**" zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Arlind Spahija shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 14/04/1989, lindur në Shkodër me nr. ID 190414117H, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 034796378 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% të kapitalit, ku një kuotë ka vlerën **1,000,000** lekë.

Arsit Hoxha shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 06/05/1995, lindur në Shkodër me nr. ID: J50506095B, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 036583816 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% të kapitalit, ku një kuotë ka vlerën **1,000,000** lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rrizgjedhje.



NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet Z. **Arsit Hoxha** shtetas Shqiptar, i ditëlindjes 06/05/1995, lindur në Shkodër me nr. ID: J50506095B me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi të kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Arlind Spahija



Arsit Hoxha

